

Draft Konventa e Minamatës mbi Mërkurin

Palët e kësaj Konvente,

Duke pranuar se mërkuri është një substancë kimike, e cila për shkak të transportimit të saj atmosferik në një rreze të largët, qëndrueshmërisë së saj në mjedis kur shfaqet antropogjenikisht, aftësisë së saj të akumulimit biologjik në ekosisteme dhe pasojave tejet negative në shëndetin e njerëzve dhe mjedis, përbën një shqetësim global.

Duke risjellë në vëmendje vendimin 25/5 të 20 shkurtit 2009 të Këshillit Drejtues të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin mbi fillimin e veprimeve ndërkombëtare për menaxhimin e mërkurit me efektshmëri, efikasitet dhe në mënyrë koherente,

Duke iu referuar paragrafit 221 të dokumentit rezultues nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm “E Ardhmja që Dëshirojmë”, ku u shpreh kërkesa për një përfundim të suksesshëm të negociatave me një instrument global të detyrueshëm për mërkurin, i cili trajton rreziqet ndaj shëndetit të njerëzve dhe mjedisit,

Duke rikujtuar parimet e Deklaratës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, përfshirë ndër të tjera, përgjegjësi të përbashkëta por të ndryshme, dhe duke pranuar rrethanat dhe aftësitë përkatëse të Shteteve, si edhe nevojën për veprime globale,

Të ndërgjegjshme për shqetësimet shëndetësore, veçanërisht në vendet e zhvilluara si rrjedhojë e ekspozimit të popullsisë së cënueshme ndaj mërkurit, në veçanti gratë, fëmijët, dhe nëpërmjet tyre, brezat e ardhshëm,

Duke vërejtur ekspozimet e veçanta të ekosistemeve arktike dhe komuniteteve indigjene për shkak të akumulimit biologjik të mërkurit dhe kontaminimit të ushqimeve tradicionale dhe duke qenë të shqetësuar për komunitet indigjene në përgjithësi në lidhje me efektet e mërkurit,

Duke pranuar mësimet thelbësore të Sëmundjes Minamata, veçanërisht pasojat e rënda shëndetësore dhe mjedisore si rrjedhojë e ndotjes nga mërkuri, dhe nevojës për të siguruar menaxhimin e duhur të mërkurit dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla në të ardhmen,

Duke theksuar rëndësinë e mbështetjes financiare, teknike, teknologjike dhe rritjes së kapaciteteve, në veçanti për vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion ekonomik, me qëllim që të forcojnë aftësitë kombëtare për menaxhimin e mërkurit dhe për të nxitur zbatimin efikas të Konventës,

Duke pranuar edhe veprimtaritë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve në lidhje me mërkurin dhe rolet e marrëveshjeve përkatëse mjedisore shumë-palëshe, në veçanti Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre dhe Konventa e Roterdamit mbi Procedurën e Njoftimit të Pëlqimit Paraprak për disa Substanca të Rrezikshme Kimike dhe Pesticide në Tregun Ndërkombëtar,

Duke pranuar se kjo Konventë dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare në fushën e mjedisit dhe tregtisë mbështesin reciprokisht njëra-tjetrën,

Duke theksuar se asgjë në këtë Konventë nuk ka si qëllim të cenojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga ndonjë marrëveshje ekzistuese ndërkombëtare,

Duke kuptuar se paraqitja e mësipërme e fakteve nuk ka si qëllim të vendosë ndonjë hierarki ndërmjet Konventës dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë,

Duke vërejtur se asgjë në këtë Konventë nuk ndalon ndonjë nga Palët për të marrë masa të tjera kombëtare në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, si përpjekje në mbrojtje të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga ekspozimi ndaj merkurit, në përputhje me detyrimet e tjera të asaj Pale sipas të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivi

Objektivi i kësaj Konvente është të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga emetimet dhe çlirimet antropogjenike të merkurit dhe përbërësve të tij.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

- (a) “Nxjerrja artizanale dhe në një shkallë të vogël e mineralit të arit” nënkupton nxjerrjen e arit nga minatorë individualë ose nga firma të vogla me kapital të kufizuar investimi dhe prodhimi;
- (b) “Teknikat më të mira në dispozicion” nënkuptojnë ato teknika që janë më efikase për parandalimin dhe, nëse nuk është e praktikueshme, për reduktimin e emetimeve dhe çlirimeve të merkurit në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për minimizimin e ndikimit që këto emetime dhe çlirime kanë në mjedis në tërësi, duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe teknike për një Palë ose objekt të caktuar brenda territorit të asaj Pale. Në këtë kontekst:
 - (i) “Më e mira” nënkupton më efikasen në arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit si tërësi;
 - (ii) “Në dispozicion” në lidhje me teknikat për një Palë apo objekt të caktuar brenda territorit të asaj Pale, nënkupton ato teknika të cilat janë të zhvilluara në atë shkallë që lejojnë përdorimin e tyre në një sektor të caktuar industrial nën kushte praktike ekonomike dhe teknike, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet, nëse ato teknika përdoren ose zhvillohen ose jo brenda territorit të asaj Pale, me kusht që të jenë të aksesueshme për operatorin e atij objekti, siç përcaktohet nga ajo Palë; dhe
 - (iii) “Teknikat” nënkupton teknologjitë e përdorura, praktikat operacionale dhe mënyrën sesi janë projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, vënë në funksionim dhe çmontuar instalimet;
- (c) “Praktikat më të mira mjedisore” nënkupton zbatimin e ndërthurjes më të përshtatshme të masave dhe strategjive për kontrollin e mjedisit;
- (d) “Mërkuri” nënkupton elementin merkur (Hg(0), CAS Nr. 7439-97-6);
- (e) “Përbërësit e merkurit” nënkupton çdo substancë që përbëhet nga atome të merkurit dhe një ose më shumë atome të elementëve të tjerë kimikë që mund të veçohen në përbërës të ndryshëm vetëm me reaksione kimike;
- (f) “Produkt me merkur të shtuar” nënkupton një produkt ose përbërës të produktit që përmban merkur ose një përbërës të merkurit të shtuar qëllimisht;
- (g) “Palë” nënkupton një Shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik që ka rënë dakord t’i përmbahet kësaj Konvente dhe për të cilën Konventa është në fuqi;
- (h) “Palë të pranishme dhe votuese” nënkupton Palët e pranishme që votojnë pro ose kundër në takimin e Palëve;
- (i) “Nxjerrja parësore e mineralit të merkurit” nënkupton nxjerrje mineralesh, ku materiali kryesor që kërkohet është merkur;

(j) “Organizatë rajonale e integritit ekonomik” nënkupton një organizatë të përbërë nga Shtete sovraane të një rajoni të caktuar, së cilës Shtetet anëtare i kanë kaluar kompetencën në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë dhe që është autorizuar siç duhet, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, për të nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar apo aderuar në këtë Konventë; dhe

(k) “Përdorim i lejuar” nënkupton çdo përdorim të mërkurit apo përbërësve të tij nga një Palë në përputhje me këtë Konventë, përfshirë por pa u kufizuar tek përdorimet në përputhje me Nenet 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Neni 3

Burimet e rezervave të mërkurit dhe tregtimi

1. Për qëllime të këtij Neni:

(a) Referimet ndaj “mërkurit” përfshijnë përzierjet e mërkurit me substanca të tjera, përfshirë edhe aliazhe mërkuri, me një përqendrim të mërkurit të paktën 95 për qind të peshës; dhe

(b) “Përbërësit e mërkurit” nënkupton mërkurin (I) klorid (të njohur si kalomel), mërkurin (II) oksid, mërkurin (II) sulfat, mërkurin (II) nitrat, cinabarin dhe sulfidin e mërkurit

2. Dispozitat e këtij Neni nuk zbatohen për:

(a) Sasitë e mërkurit apo përbërësit e tij që përdoren për kërkime në shkallë laboratorike ose si standard referimi; apo

(b) Sasitë gjurmë mërkuri ose të përbërësve të tij që janë në gjendje natyrore në produkte të tilla si metale jo-mërkuri, xeherorë, ose produkte minerale si qymyri apo produkte të përfutuara nga këto materiale, dhe sasitë gjurmë të paqëllimshme në produktet kimike; ose

(c) Produktet me mërkur të shtuar.

3. Çdo Palë nuk duhet të lejojë nxjerrjen parësore të mineralit të mërkurit që nuk po kryhet brenda territorit të saj, në datën e hyrjes në fuqi të Konventës.

4. Çdo Palë duhet të lejojë nxjerrjen parësore të mineralit të mërkurit që po kryhet brenda territorit të saj në datën e hyrjes në fuqi të Konventës, vetëm për një periudhë pesëmbëdhjetë vjeçare pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Gjatë kësaj periudhe mërkuri i nxjerrë duhet të përdoret vetëm për prodhimin e produkteve me mërkur të shtuar në pajtim me Nenin 4, në proceset e prodhimit në përputhje me Nenin 5, ose të asgjësohet në pajtim me Nenin 11, duke përdorur veprime që nuk sjellin riaftësimin, riciklimin, përmirësimin, ri-përdorimin e drejtpërdrejtë apo përdorime alternative të tij.

5. Çdo Palë duhet:

(a) Të përpiqet që të identifikojë depozita individuale të mërkurit apo të përbërësve të tij mbi 50 tonë, si edhe burime të rezervave të mërkurit që gjenerojnë depozita mbi 10 tonë në vit, të cilat gjenden brenda territorit të saj

(b) Të marrë masa që të sigurojë, në rast se Pala konstaton teprica mërkuri nga çmontimi i objekteve klor-alkalike, asgjësimin e këtij mërkuri në përputhje me udhëzimet mbi menaxhimin e duhur të mjedisit, i referuar në paragrafin 3 (a) Neni 11, duke përdorur veprime që nuk sjellin riaftësimin, riciklimin, përmirësimin, ri-përdorimin e drejtpërdrejtë apo përdorime alternative të tij.

6. Çdo Palë ndalon eksportimin e mërkurit, me përjashtim të rasteve të mëposhtëme:
- (a) Një Palë i ka dhënë Palës eksportuese pëlqimin e saj me shkrim, dhe vetëm për qëllime:
 - (i) Të një përdorimi të lejuar të Palës importuese në përputhje me këtë Konventë; ose
 - (ii) Për magazinimin e përkohshëm të duhur mjedisor, siç përcaktohet në Nenin 10; ose
 - (b) Një jo-Palë i ka dhënë Palës eksportuese pëlqimin me shkrim, si edhe vërtetimin që tregon se:
 - (i) Jo-Pala ka marrë masa që garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit dhe pajtueshmërinë me dispozitat e Neneve 10 dhe 11; dhe
 - (ii) Ky mërkur do të përdoret nga Pala vetëm për një përdorim të lejuar sipas kësaj Konvente apo për magazinimin e përkohshëm të duhur mjedisor, siç përcaktohet në Nenin 10
7. Pala eksportuese mund të mbështetet në një njoftim të përgjithshëm që Pala ose jo-Pala importuese i dorëzon Sekretariatit, në formën e miratimit me shkrim sipas paragrafit 6. Ky njoftim i përgjithshëm duhet të përcaktojë çdo afat dhe kusht sipas të cilave Pala ose jo-Pala importuese jep miratimin e saj. Njoftimi mund të revokohet në çdo kohë nga ajo Palë ose jo-Palë. Sekretariati mban një regjistër publik të të gjitha këtyre njoftimeve.
8. Çdo Palë nuk e lejon importimin e mërkurit nga një jo-Palë së cilës do t'i japë miratimin me shkrim, në rast se jo-Pala nuk vërteton se mërkuri nuk e ka origjinën nga burimet e identifikuar si të jo-lejuara sipas paragrafit 3 ose paragrafit 5 (b).
9. Një Palë që dorëzon një njoftim të përgjithshëm miratimi sipas paragrafit 7, mund të marrë vendimin që të mos zbatojë paragrafin 8, me kusht që të ruajë kufizime gjithëpërfshirëse për eksportimin e mërkurit dhe të ketë masa kombëtare që sigurojnë se importimi i mërkurit menaxhohet në mënyrën e duhur mjedisore. Pala duhet të njoftojë Sekretariatin për këtë vendim dhe t'i dorëzojë atij informacionin që përshkruan kufizimet eksportuese dhe masat rregullatore vendase, si edhe informacionin mbi sasinë dhe vendet e origjinës së mërkurit të importuar nga jo-Palët. Sekretariati duhet të mbajë një regjistër publik të të gjitha këtyre njoftimeve. Komiteti i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë rishikon dhe vlerëson çdo njoftim të tillë dhe informacion mbështetës në përputhje me Nenin 15 dhe i bën rekomandimet e duhura Konferencës së Palëve.
10. Procedura e përcaktuar në paragrafin 9 është e disponueshme deri në përfundimin e takimit të dytë të Konferencës së Palëve. Pas kësaj kohe ajo nuk është më e disponueshme, vetëm nëse Konferenca e Palëve vendos ndryshe me shumicë të thjeshtë të Palëve të pranishme dhe që votojnë, me përjashtim të ndonjë Pale, e cila ka dorëzuar para përfundimit të takimit të dytë të Konferencës së Palëve një njoftim sipas paragrafit 9.
11. Çdo Palë duhet të përfshijë në raportet që ajo dorëzon sipas Nenit 21, informacionin që tregon se kërkesat e këtij Neni janë përmbushur.
12. Gjatë takimit të saj të parë, Konferenca e Palëve jep udhëzime të mëtejshme në lidhje me këtë Nen, në veçanti në lidhje me paragrafët 5 (a), 6 dhe 8, dhe përpilon e miraton përmbajtjen e duhur të vërtetimit të cilësuar në paragrafët 6 (b) dhe 8.
13. Konferenca e Palëve vlerëson nëse tregtimi i përbërësve të caktuar të mërkurit përfshin objektivin e kësaj Konvente dhe shqyrton nëse përbërës të veçantë të mërkurit, të renditur në një shtojcë plotësuese të miratuar në përputhje me Nenin 27, duhet t'u nënshtrohen paragrafëve 6 dhe 8.

Neni 4**Produkte me mërkur të shtuar**

1. Çdo Palë merr masat e duhura për të mos lejuar prodhimin, importimin ose eksportimin e produkteve me mërkur të shtuar, të renditura në Pjesën I të Shtojcës A pas datës së heqjes së tyre nga përdorimi, vetëm nëse në Shtojcën A specifikohet ndonjë përjashtim ose Pala ka një përjashtim të regjistruar sipas Nenit 6.

2. Si alternativë ndaj paragrafit 1, një Palë mund të tregojë në kohën e ratifikimit ose pas hyrjes në fuqi të ndonjë amendamenti ndaj Shtojcës A, se ajo do të zbatojë masa apo strategji të ndryshme në lidhje me produktet e shënuara në Pjesën I të Shtojcës A. Një Palë mund ta zgjedhë këtë alternativë, nëse provon se në kohën kur njofton Sekretariatit mbi vendimin e saj për të përdorur këtë alternativë, ajo ka reduktuar në nivel minimal prodhimin, importimin dhe eksportimin e pjesës më të madhe të produkteve të shënuara në Pjesën I të Shtojcës A, dhe se ka zbatuar masa apo strategji për reduktimin e përdorimit të mërkurit në produkte të tjera që nuk janë të shënuara në Pjesën A të Shtojcës A. Për më tepër, një Palë që ka zgjedhur këtë alternativë duhet:

(a) Të raportojë tek Konferenca e Palëve, sapo t'i jepet mundësia, një përshkrim të masave ose strategjive të zbatuara, duke përfshirë edhe sasinë e reduktimeve të arritura;

(b) Të zbatojë masa ose strategji për reduktimin e përdorimit të mërkurit në secilin prej produkteve të shënuara në Pjesën I të Shtojcës A, për të cilat nuk është arritur ende vlera minimale;

(c) Të marrë në konsideratë masa të tjera për të arritur reduktime të mëtejshme; dhe

(d) Të mos gëzojë të drejtën e përjashtimeve, sipas Nenit 6, për çdo kategori të produktit për të cilin është zgjedhur kjo alternativë.

Jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Konferenca e Palëve duhet të rishikojë progresin e efikasitetit të masave të marra sipas këtij paragrafi, si pjesë e procesit të rishikimit të cilësuar në paragrafin 8.

3. Çdo Palë duhet të marrë masa në lidhje me produktet me mërkur të shtuar të shënuara në Pjesën II të Shtojcës A në përputhje me dispozitat e përcaktuara në të.

4. Në bazë të informacionit që japin Palët, Sekretariati grumbullon dhe ruan informacionin mbi produktet me mërkur të shtuar dhe alternativat e tyre, duke e vënë këtë informacion në dispozicion. Sekretariati vë në dispozicion çdo informacion tjetër përkatës të dorëzuar nga Palët.

5. Çdo Palë duhet të marrë masat për të parandaluar futjen e produkteve me mërkur të shtuar tek produktet e montuara, importimi dhe eksportimi i të cilave nuk lejohet sipas këtij Neni.

6. Çdo Palë nuk duhet të mbështesë prodhimin dhe hedhjen në treg të produkteve me mërkur të shtuar, të cilat nuk bëjnë pjesë në përdorimin e njohur të produkteve me mërkur të shtuar para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, përveç kur përcaktohet se ka përfitime mjedisore apo për shëndetin e njerëzve në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe përfitimeve të produktit. Një Palë i dorëzon Sekretariatit, nëse duhet, informacionin rreth këtij produkti, përfshirë edhe informacionin mbi rreziqet e përfitimet e këtij produkti për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Sekretariati vë në dispozicion këtë informacion.

7. Çdo Palë mund të paraqesë një propozim tek Sekretariati për të shënuar një produkt me mërkur të shtuar në Shtojcën A. Ky propozim përmban informacionin në lidhje me disponueshmërinë, realizueshmërinë teknike dhe ekonomike, si dhe rreziqet e përfitimet për mjedisin e shëndetin të produkteve alternative pa mërkur të këtij produkti, duke marrë parasysh informacionin në përputhje me paragrafin 4.

8. Jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të Konventës, Konferenca e Palëve rishikon Shtojcën A dhe mund të marrë në konsideratë amendamentet ndaj kësaj Shtojce, në përputhje me Nenin 27.

9. Gjatë rishikimit të Shtojcës A në përputhje me paragrafin 8, Konferenca e Palëve merr parasysh të paktën:

- (a) Çdo propozim të paraqitur sipas paragrafit 7;
- (b) Informacionin e vënë në dispozicion sipas paragrafit 4; dhe
- (c) Disponueshmërinë e Palëve për alternativa pa mërkur, të cilat janë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme duke marrë parasysh rreziqet e përfitimet për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

Neni 5

Proceset e prodhimit ku përdoret mërkuri ose përbërësit e tij

1. Për qëllime të këtij Neni dhe Shtojcës B, proceset e prodhimit ku përdoret mërkuri apo përbërësit e tij nuk duhet të përfshijnë procese që përdorin produkte me mërkur të shtuar, proceset për prodhimin e produkteve me mërkur të shtuar ose proceset që përpunojnë mbetjet me përmbajtje mërkuri.

2. Duke marrë masat e duhura, çdo Palë nuk duhet të lejojë përdorimin e mërkurit apo përbërësve të tij në proceset e prodhimit të renditura në Pjesën I të Shtojcës B pas datës së heqjes së tyre nga përdorimi, të specifikuar në atë Shtojcë për proceset individuale, vetëm në rastet kur Pala ka një përjashtim të regjistruar sipas Nenit 6.

3. Çdo Palë duhet të marrë masat për kufizimin e përdorimit të mërkurit apo përbërësve të tij në proceset e përmendura në Pjesën II të Shtojcës B në përputhje me dispozitat e përcaktuara për këtë.

4. Në bazë të informacionit që japin Palët, Sekretariati mbledh dhe ruan informacionin mbi proceset që përdorin mërkurin apo përbërësit e saj dhe alternativat e tyre, duke e vënë këtë informacion në dispozicion. Sekretariati vë në dispozicion çdo informacion tjetër përkatës të dorëzuar nga Palët.

5. Çdo Palë me një ose më shumë objekte që përdor mërkurin apo përbërësit e tij në proceset e prodhimit të shënuara në Shtojcën B:

- (a) Merr masa në lidhje me emetimet dhe çlirimet e mërkurit apo përbërësve të tij nga këto objekte;
- (b) Përfshin, në raportet që paraqet në përputhje me Nenin 21, informacionin mbi masat e marra në përputhje me këtë paragraf; dhe

(c) Përpiqet që të identifikojë objektet brenda territorit të saj, të cilat përdorin mërkurin apo përbërësit e tij në proceset e shënuara në Shtojcën B dhe i dorëzon Sekretariatit, jo më vonë se tre vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, informacion mbi numrin dhe llojet e këtyre objekteve dhe sasinë e llogaritur vjetore të mërkurit apo përbërësve të tij që përdoren në ato objekte. Sekretariati vë në dispozicion këto informacion.

6. Çdo Palë nuk e lejon përdorimin e mërkurit apo përbërësve të tij në një objekt që përdor proceset e prodhimit të shënuara në Shtojcën B, i cili nuk ka ekzistuar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Asnjë përjashtim nuk zbatohet për këto objekte.

7. Çdo Palë nuk e mbështet ngritjen e ndonjë objekti që nuk ka ekzistuar para datës së hyrjes në fuqi të Konventës, dhe që përdor ndonjë proces tjetër prodhimi ku mërkuri apo përbërësit e tij përdoren qëllimisht, vetëm nëse Pala e bind Konferencën e Palëve se procesi i prodhimit siguron përfitime të rëndësishme mjedisore dhe shëndetësore dhe se nuk ka alternativa të tjera pa mërkur teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, të cilat i ofrojnë këto përfitime.

8. Palët inkurajohen që të shkëmbejnë informacionin rreth zhvillimeve të reja përkatëse teknologjike, alternativave pa mërkur teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, dhe rreth masave të teknikave të mundshme për reduktimin dhe kur është e mundur, eliminimin e përdorimit të mërkurit apo përbërësve të tij, si dhe emetimin e çlirimit të mërkurit dhe përbërësve të tij nga proceset e prodhimit të shënuara në Shtojcën B.

9. Çdo Palë mund të paraqesë një propozim për të ndryshuar Shtojcën B, me qëllim që të shënohet një proces prodhimi ku përdoret mërkuri apo përbërësit e tij. Propozimi përfshin informacion në lidhje me disponueshmërinë, realizueshmërinë teknike dhe ekonomike, si dhe rreziqet e përfitimit që alternativa pa mërkur të këtij procesi ka për mjedisin dhe shëndetin.

10. Jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të Konventës, Konferenca e Palëve rishikon Shtojcën B dhe mund të shqyrtojë amendamentet e kësaj Shtojce në përputhje me Nenin 27.

11. Gjatë rishikimit të Shtojcës B sipas paragrafit 10, Konferenca e Palëve duhet të marrë parasysh të paktën:

- (a) Çdo propozim të paraqitur sipas paragrafit 9;
- (b) Informacionin e vënë në dispozicion sipas paragrafit 4; dhe
- (c) Disponueshmërinë e Palëve për alternativa pa mërkur, të cilat janë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, duke marrë parasysh rreziqet e përfitimit për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

Neni 6

Përjashtimet e disponueshme me kërkesë të Palës

1. Çdo Shtet apo organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të regjistrohet për një apo më shumë përjashtime në lidhje me datën e heqjes nga përdorimi të shënuar në Shtojcën A dhe Shtojcën B, të referuar më poshtë si “përjashtimi”, duke e njoftuar Sekretariatit me shkrim:

- (a) Kur bëhesh Palë e kësaj Konvente; ose

(b) Jo më vonë se data kur amendamenti i zbatueshëm hyn në fuqi për Palën, në rast të ndonjë produkti me mërkur të shtuar që i është shtuar me amendament Shtojcës A ose për ndonjë proces prodhimi ku përdoret mërkuri që i është shtuar me amendament Shtojcës B.

Çdo regjistrim i tillë duhet të shoqërohet nga një deklaratë ku shpjegohet arsyeja e Palës për këtë përjashtim.

2. Një përjashtim mund të regjistrohet ose për një kategori të shënuar në Shtojcën A apo B, ose për një nën-kategori të identifikuar nga çdo Shtet apo organizatë rajonale e integritit ekonomik.

3. Çdo palë që ka një ose më shumë përjashtime, shënohet në regjistër. Sekretariati krijon dhe mban regjistrin dhe gjithashtu e vë në dispozicion.

4. Regjistri duhet të përfshijë:

- (a) Një listë të Palëve që kanë një ose më shumë përjashtime;
- (b) Përjashtimin ose përjashtimet e regjistruara për secilën Palë; dhe
- (c) Datën e skadimit të çdo përjashtimi.

5. Në rast se Pala nuk regjistron një periudhë më të shkurtër, të gjitha përjashtimet sipas paragrafit 1 do të skadojnë pesë vjet pas datës përkatëse të heqjes nga përdorimi të shënuar në Shtojcën A ose B.

6. Konferenca e Palëve, me kërkesë të Palës, mund të vendosë shtyrjen e përjashtimit për pesë vjet, nëse Pala nuk kërkon një periudhë më të shkurtër. Për marrjen e këtij vendimi, Konferenca e Palëve duhet të marrë parasysh në mënyrën e duhur:

(a) Raportin e paraqitur nga Pala, ku arsyetohet nevoja e shtyrjes së përjashtimit dhe ku përmbledhen aktivitetet e ndërmarra dhe të planifikuara për të eliminuar nevojën e përjashtimit sa më shpejt që të jetë e mundur;

(b) Informacionin në dispozicion, në lidhje me disponueshmërinë e produkteve dhe proceseve alternative pa mërkur ose që përfshijnë përdorimin e mërkurit më pak sesa në përdorimin e përjashtuar; dhe

(c) Aktivitetet e planifikuara ose që janë duke u planifikuar, të cilat sigurojnë magazinimin e duhur të mërkurit për mjedisin dhe asgjësimin e mbetjeve të mërkurit.

Një përjashtim mund të shtyhet vetëm një herë për produkt për datë të heqjes nga përdorimi.

7. Një Palë e tërheq përjashtimin në çdo kohë pasi ka njoftuar me shkrim Sekretariatin. Tërheqja e përjashtimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar në njoftim.

8. Pavarësisht nga paragrafi 1, asnjë Shtet apo organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk mund të regjistrohet për një përjashtim pas pesë vjetësh nga data e heqjes nga përdorimi për produktin apo procesin në fjalë, e renditur në Shtojcën A ose B, përveç kur një apo më shumë Palë vazhdojnë të jenë të regjistruara për përjashtimin për atë produkt apo proces, pasi u është dhënë një shtyrje sipas paragrafit 6. Në këtë rast, një Shtet apo organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të regjistrohet për një përjashtim për atë produkt apo proces, në afatet e përcaktuara në paragrafët 1 (a) dhe (b), përjashtim i cili duhet të skadojë dhjetë vjet pas datës përkatëse të heqjes nga përdorimi.

9. Asnjë Palë nuk mund të ketë një përjashtim në fuqi pas 10 vjetësh nga data e heqjes nga përdorimi të një produkti apo procesi të shënuar në Shtojcën A ose B.

Neni 7

Nxjerrja artizanale dhe në shkallë të vogël e mineralit të arit

1. Masat në këtë Nen dhe në Shtojcën C zbatohen për nxjerrjen dhe përpunimin artizanal e në shkallë të vogël të mineralit të arit, ku përdoret përzierje mërkuri për të nxjerrë ar nga xeherori.
2. Çdo Palë që ka brenda territorit të saj nxjerrje dhe përpunim artizanal e në shkallë të vogël të mineralit të arit, që i nënshtrohet këtij Neni, merr masa për reduktimin dhe nëse e mundur për eliminimin e përdorimit të mërkurit dhe përbërësve të tij, si dhe për emetimet e çlirimet e mërkurit nga kjo nxjerrje dhe përpunim mineralesh.
3. Çdo Palë e njofton Sekretariatit, nëse konstaton në çdo kohë se nxjerrja e përpunimi artizanal dhe në shkallë të vogël i mineralit të arit në territorin e saj është më e rëndësishme. Nëse Pala e konstaton këtë, ajo:
 - (a) Harton dhe zbaton një plan kombëtar veprimi në përputhje me Shtojcën C;
 - (b) Dorëzon planin e saj kombëtar të veprimit tek Sekretariati jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës ose jo më vonë se tre vjet pas njoftimit të Sekretariatit, cilito që është më i vonë; dhe
 - (c) Pas kësaj, kontrollon çdo tre vjet progresin e bërë në përmbushjen e detyrimeve të cilësuar në këtë Nen dhe këto kontrolle i përfshin në raportet që paraqet në përputhje me Nenin 21.
4. Palët mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me organizatat përkatëse ndërqeveritare dhe subjekte të tjera, kur është e nevojshme, për të përmbushur objektivat e këtij Neni. Ky bashkëpunim mund të përfshijë:
 - (a) Zhvillimin e strategjive për të parandaluar ndërfutjen e mërkurit apo përbërësve të tij gjatë përdorimit për nxjerrjen e përpunimin artizanal dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit;
 - (b) Nisma arsimore, shërbimesh dhe për rritjen e kapaciteteve;
 - (c) Nxitjen e kërkimeve shkencore për praktika alternative të qëndrueshme pa mërkur;
 - (d) Ofrimin e asistencës teknike dhe financiare;
 - (e) Partneritete për të ndihmuar zbatimin e angazhimeve sipas këtij Neni; dhe
 - (f) Përdorimin e mekanizmave ekzistues të shkëmbimit të informacionit për të promovuar njohuritë, praktikat më të mira mjedisore dhe teknologjitë alternative të zbatueshme, duke marrë parasysh faktorët mjedisorë, teknikë, socialë dhe ekonomikë.

Neni 8

Emetimet

1. Ky Nen trajton kontrollin dhe nëse e mundur, reduktimin e emetimeve në atmosferë të mërkurit dhe përbërësve të tij, shpesh e shprehur si “mërkuri i plotë”, nëpërmjet masave të kontrollit të emetimeve nga pikat e burimit që bëjnë pjesë në kategoritë e burimit të renditura në Shtojcën D.

2. Për qëllime të këtij Neni:

(a) “Emetime” nënkupton emetime të mërkurit dhe përbërësve të tij në atmosferë;

(b) “Burim përkatës” nënkupton burimin që bën pjesë në kategoritë e burimit të shënuara në Shtojcën D. Një Palë, sipas zgjedhjes së saj, mund të përcaktojë kriteret për identifikimin e burimeve brenda kategorisë së burimit të shënuar në Shtojcën D, për atë kohë sa ato kriteret për çdo kategori përfshijnë të paktën 75 për qind të emetimeve nga ajo kategori;

(c) “Burim i ri” nënkupton çdo burim përkatës brenda kategorisë së shënuar në Shtojcën D, ndërtimi ose modifikimi thelbësor i të cilit ka filluar të paktën një vit pas datës së:

(i) Hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Palën në fjalë; ose

(ii) Hyrjes në fuqi të amendamentit të Shtojcës D për Palën në fjalë, ku burimi i nënshtrohet dispozitave të kësaj Konvente vetëm për shkak të atij amendamenti;

(d) “Modifikim thelbësor” nënkupton modifikimin e burimit përkatës që sjell si pasojë një rritje të konsiderueshme të emetimeve, duke përjashtuar çdo lloj ndryshimi të emetimeve që rrjedhin nga përpunimi i nën-produktit. Palës i përket si çështje që të vendosë nëse modifikimi është thelbësor ose jo;

(e) “Burim ekzistues” nënkupton çdo burim përkatës që nuk është burim i ri;

(f) “Vlera kufi e emetimit” nënkupton një kufi në përqendrimin, masën ose shkallën e emetimit të mërkurit apo përbërësve të tij, shpesh e shprehur si “mërkuri i plotë” që emetohet nga një pikë burimi.

3. Një palë me burimet përkatëse merr masa për kontrollin e emetimeve dhe përgatit një plan kombëtar ku përcaktohen masat që do të merren për kontrollin e emetimeve, si dhe synimet, qëllimet e rezultatet e pritshme. Çdo plan i dorëzohet Konferencës së Palëve brenda katër viteve nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për atë Palë. Nëse një Palë harton një plan zbatimi në pajtim me Nenin 20, Pala mund të përfshijë në të planin e përgatitur në pajtim me këtë paragraf.

4. Për burimet e reja çdo Palë kërkon përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme dhe praktikave më të mira mjedisore për kontrollin, kur është e mundur, për reduktimin e emetimeve sa më shpejt që të jetë e praktikueshme por jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për atë Palë. Një Palë mund të përdorë vlerat kufi të emetimit në përputhje me aplikimin e teknikave më të mira të disponueshme.

5. Për burimet ekzistuese çdo Palë përfshin në planin kombëtar dhe zbaton një ose më shumë nga masat e mëposhtme, sa më shpejt që të jetë e praktikueshme por jo më vonë se dhjetë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, duke marrë parasysh rrethanat kombëtare dhe realizueshmërinë ekonomike e teknike dhe përballueshmërinë e masave:

- (a) Një qëllim të matshëm për kontrollin dhe nëse e mundur, për reduktimin e emetimeve nga burimet përkatëse;
- (b) Vlerat kufi të emetimit për kontrollin, dhe nëse e mundur, për reduktimin e emetimeve nga burimet përkatëse;
- (c) Përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme dhe praktikat më të mira mjedisore për kontrollin e emetimeve nga burimet përkatëse;
- (d) Një strategji për kontrollin e disa llojeve ndotjeje që do të sillte bashkë-përfitime për kontrollin e emetimeve të mërkurit;
- (e) Masa alternative për reduktimin e emetimeve nga burimet përkatëse.
6. Palët mund të zbatojnë masa të njëjta për të gjitha burimet ekzistuese përkatëse ose mund të miratojnë masa të ndryshme në lidhje me kategoritë e ndryshme të burimit. Masat që zbatohen nga një Palë kanë si objektiv të arrijnë një progres të arsyeshëm në reduktimin e emetimeve me kalimin e kohës.
7. Çdo Palë mban një inventar të emetimeve nga burimet përkatëse, sa më shpejt që të jetë e praktikueshme dhe jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.
8. Në takimin e parë, Konferenca e Palëve miraton udhëzime për:
- (a) Teknikat më të mira të disponueshme dhe praktikat më të mira mjedisore, duke marrë parasysh çdo dallim ndërmjet burimeve të reja dhe atyre ekzistuese dhe nevojën për të minimizuar pasojat ndër-mjedisore; dhe
- (b) Mbështetjen që u jepet Palëve për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 5, në veçanti për përcaktimin e qëllimeve dhe vlerave kufi të emetimit.
9. Konferenca e Palëve, sa më shpejt që të jetë e praktikueshme, miraton udhëzime për:
- (a) Kriteret që Palët mund të përcaktojnë sipas paragrafit 2 (b);
- (b) Metodologjinë për përgatitjen e inventarëve të emetimit.
10. Konferenca e Palëve rishikon dhe përditëson siç duhet, udhëzimet e hartuara sipas paragrafëve 8 dhe 9. Palët marrin parasysh udhëzimet gjatë zbatimit të dispozitave përkatëse të këtij Neni.
11. Çdo Palë përfshin në raportet që dorëzon sipas Nenit 21 informacionin rreth zbatimit të këtij Neni, veçanërisht informacionin në lidhje me masat që ka marrë në përpunje me paragrafët 4 deri 7 dhe për efikasitetin e masave.

Neni 9

Çlirimet

1. Ky Nen trajton kontrollin dhe nëse e mundur, reduktimin e çlirimeve të mërkurit dhe përbërësve të tij, shprehur shpesh si “mërkuri i plotë” në tokë dhe ujë nga pikat përkatëse të burimeve që nuk trajtohen në dispozitat e tjera të kësaj Konvente.
2. Për qëllime të këtij Neni:
- (a) “Çlirime” nënkupton çlirime të mërkurit apo përbërësve të tij në tokë ose ujë;

- (b) “Burim përkatës” nënkupton çdo pikë antropogjenike të rëndësishme të burimit të çlirimit, të identifikuar nga Pala e që nuk trajtohet në dispozita të tjera të kësaj Konvente;
- (c) “Burim i ri” nënkupton çdo burim përkatës, ndërtimi ose modifikimi thelbësor i të cilit ka filluar të paktën një vit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Palën në fjalë;
- (d) “Modifikim thelbësor” nënkupton modifikimin e burimit përkatës që sjell si pasojë një rritje të konsiderueshme të çlirimeve, duke përjashtuar çdo lloj ndryshimi të çlirimeve që rrjedh nga përpunimi i nën-produktit. Palës i përket si çështje që të vendosë nëse modifikimi është thelbësor ose jo;
- (e) “Burim ekzistues” nënkupton çdo burim përkatës që nuk është burim i ri;
- (f) “Vlera kufi e çlirimit” nënkupton një kufi në përqendrimin ose masën e mërkurit apo përbërësve të tij, shpesh i shprehur si “mërkur i plotë” që çlirohet nga një pikë burimi.
3. Çdo Palë identifikon, jo më vonë se tre vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe më pas rregullisht, kategoritë e pikave përkatëse të burimit.
4. Një palë me burimet përkatëse merr masa për kontrollin e çlirimeve dhe përgatit një plan kombëtar ku përcaktohen masat që do të merren për kontrollin e çlirimeve, si dhe synimet, qëllimet e rezultatet e pritshme. Çdo plan i dorëzohet Konferencës së Palëve brenda katër viteve nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për atë Palë. Nëse një Palë harton një plan zbatimi në pajtim me Nenin 20, Pala mund të përfshijë në të planin e përgatitur në pajtim me këtë paragraf.
5. Sipas rastit masat përfshijnë një ose më shumë nga sa më poshtë:
- (a) Vlerat kufi të emetimit për kontrollin, dhe nëse e mundur, për reduktimin e çlirimeve nga burimet përkatëse;
- (b) Përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme dhe praktikave më të mira mjedisore për kontrollin e çlirimeve nga burimet përkatëse;
- (c) Një strategji për kontrollin e disa llojeve ndotjeje që do të sillte bashkë-përfitime për kontrollin e çlirimeve të mërkurit;
- (d) Masa alternative për reduktimin e çlirimeve nga burimet përkatëse.
6. Çdo Palë mban një inventar të çlirimeve nga burimet përkatëse, sa më shpejt që të jetë e praktikueshme dhe jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.
7. Konferenca e Palëve, sa më shpejt që të jetë e praktikueshme, miraton udhëzimet për:
- (a) Teknikat më të mira të disponueshme dhe praktikave më të mira mjedisore, duke marrë parasysh çdo dallim ndërmjet burimeve të reja dhe atyre ekzistuese, si dhe nevojën për të minimizuar pasojat ndër-mjedisore; dhe
- (b) Metodologjinë për përgatitjen e inventarëve të çlirimit.
8. Çdo Palë përfshin në raportet që dorëzon sipas Nenit 21, informacionin rreth zbatimit të këtij Neni, veçanërisht informacionin në lidhje me masat që ka marrë në përpunime me paragrafët 3-6 dhe për efikasitetin e masave.

Neni 10**Magazinimi i duhur mjedisor i përkohshëm i mërkurit, përveç mbetjeve të mërkurit**

1. Ky nen zbatohet për magazinimin e përkohshëm të mërkurit dhe përbërësve të tij, siç përcaktohet në Nenin 3 që nuk bën pjesë brenda kuptimit të përkufizimit të mbetjeve të mërkurit që cilësohen në Nenin 11.
2. Çdo Palë merr masat që sigurojnë se magazinimi i përkohshëm i këtij mërkuri apo përbërësve të tij, për përdorim të lejuar nga një Palë sipas kësaj Konvente, është ndërmarrë në mënyrën e duhur mjedisore, duke marrë parasysh udhëzimet dhe në pajtim me çdo kërkesë të miratuar në përputhje me paragrafin 3.
3. Konferenca e Palëve miraton udhëzimet për magazinimin e duhur mjedisor të këtij mërkuri apo përbërësve të tij, duke marrë parasysh çdo udhëzim tjetër përkatës të hartuar sipas Konventës së Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre si dhe udhëzimet e tjera përkatëse. Konferenca e Palëve mund të miratojë kërkesat për magazinimin e përkohshëm në një shtojcë plotësuese të kësaj Konvente, në përputhje me Nenin 27.
3. Palët bashkëpunojnë, siç duhet, me njëra-tjetrën dhe me organizata të tjera përkatëse ndërqeveritare dhe subjekte të tjera për përmirësimin e rritjeve të kapaciteteve në lidhje me magazinimin e duhur mjedisor të përkohshëm të këtij mërkuri dhe përbërësve të tij.

Neni 11**Mbetje mërkuri**

1. Përkufizimet përkatëse të Konventës së Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre zbatohen për mbetjet e përfshira në këtë Konventë për Palët e Konventës së Bazelit. Palët e kësaj Konvente që nuk janë Palë të Konventës së Bazelit përdorin si udhëzim ato përkufizime për mbetjet e përfshira në këtë Konventë.

2. Për qëllime të kësaj Konvente, mbetje mërkuri nënkupton substanca ose objekte:

- (a) Që përbëhen nga mërkuri ose përbërësit e tij;
- (b) Që përmbajnë mërkur ose përbërësit e tij; ose
- (c) Të kontaminuara nga mërkuri ose përbërësit e tij,

në një sasi mbi kufijtë e duhur të përcaktuara në mënyrë të harmonizuar nga Konferenca e Palëve, në bashkëpunim me organet përkatëse të Konventës së Bazelit, që asgjësohen ose janë të destinuara për t'u asgjësuar ose kërkohen që të asgjësohen nga dispozitat e të drejtës kombëtare ose të kësaj Konvente. Ky përkufizim përjashton mbingarkesën, mineralet e varfëruara dhe mineralet sterile nga nxjerrja e mineraleve, me përjashtim të nxjerrjes parësore të mërkurit, nëse ato nuk përmbajnë mërkur apo përbërësit e tij mbi normat e kufizimeve të përcaktuara nga Konferenca e Palëve.

3. Çdo Palë merr masat e duhura me qëllim që mbetjet e mërkurit të:

(a) Menaxhohen në mënyrën e duhur mjedisore, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara sipas Konventës së Bazelit dhe në përputhje me kërkesat e Konferencës së Palëve të miratohet një shtojcë plotësuese në përputhje me Nenin 27. Konferenca e Palëve merr parasysh rregulloret dhe programet e Palëve mbi menaxhimin e mbetjeve kur bën përcaktimin e kërkesave;

(b) Përpunohen, riciklohen, përmirësohen ose ri-përdoren drejtpërdrejt për përdorimin e lejuar nga një Palë sipas kësaj Konventë ose për asgjësimin e duhur mjedisor sipas paragrafit 3 (a);

(c) Mos transportohen përtej kufijve ndërkombëtarë për Palët në Konventën e Bazelit, me përjashtim të rastit kur asgjësohen sipas mënyrës së duhur mjedisore, në përputhje me këtë Nen dhe me atë Konventë. Në rastet ku Konventa e Bazelit nuk zbatohet për transportin ndërkombëtar ndërkufitar, një Palë e lejon një transportim të tillë vetëm pasi të ketë marrë parasysh rregullat, standardet dhe udhëzimet e duhura ndërkombëtare.

4. Konferenca e Palëve kërkon të bashkëpunojë ngushtë me organet përkatëse të Konventës së Bazelit për rishikimin dhe përditësimin e duhur të udhëzimeve të përmendura në paragrafin 3 (a).

5. Palët inkurajohen të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me organizatat përkatëse ndërqeveritare dhe subjekte të tjera, siç duhet, që të zhvillojnë dhe ruajnë kapacitetin global, rajonal dhe kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të mërkurit sipas mënyrës së duhur mjedisore.

Neni 12

Vendndodhjet e Kontaminuara

1. Çdo Palë përpaket për zhvillimin e strategjive të duhura që të identifikojë dhe vlerësojë vendndodhjet e kontaminuara nga mërkuri apo përbërësit e tij.
2. Çdo veprim për të reduktuar rreziqet e shkaktuara nga vendet që përmbajnë mërkur apo përbërësit e tij, kryhet sipas mënyrës së duhur mjedisore, duke përfshirë sipas rastit, një vlerësim të rreziqeve për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
3. Konferenca e Palëve miraton udhëzimet për menaxhimin e vendeve të kontaminuara, të cilat mund të përfshijnë metodat dhe qasjet për:
 - (a) Identifikimin dhe karakterizimin e vendit;
 - (b) Përfshirjen e publikut;
 - (c) Vlerësimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;
 - (d) Mundësitë në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të paraqitura nga vendet e kontaminuara;
 - (e) Vlerësimin e përfitimeve dhe shpenzimeve; dhe
 - (f) Sanksionimin e rezultateve.
4. Palët inkurajohen që të bashkëpunojnë për hartimin e strategjive dhe aktiviteteve zbatuese për të identifikuar, vlerësuar, prioritetizuar, menaxhuar siç duhet, për të rregulluar/mbrojtur vendet e kontaminuara.

Neni 13

Burimet dhe mekanizmat financiarë

1. Çdo Palë garanton të sigurojë, brenda aftësive të tij, burime në lidhje me ato aktivitete kombëtare që kanë si synim të zbatojnë këtë Konventë në përputhje me politikat, prioritetet, planet dhe programet kombëtare. Këto burime mund të përfshijnë financim të brendshëm nëpërmjet politikave përkatëse, strategjive të zhvillimit dhe buxheteve kombëtare, si dhe financimet dypalëshe e shumëpalëshe dhe përfshirjen e sektorit privat.
2. Zbatimi i kësaj Konvente me efikasitet nga shtetet Palë në zhvillim lidhet me zbatimin efikas të këtij Neni.
3. Burimet financiare shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe dhe ndihma teknike, si dhe rritja e kapaciteteve dhe transferimi i teknologjisë, inkurajohen që të përmirësojnë dhe rrisin urgjentisht aktivitetet e tyre mbi mërkurin, që të mbështesin shtetet Palë në zhvillim për zbatimin e kësaj Konvente për sa i përket burimeve financiare, asistencës teknike dhe transferimit të teknologjisë.
4. Palët marrin parasysh nevojat specifike dhe rrethanat e veçanta të Palëve që janë ishuj të vegjël me Shtete në zhvillim ose vendet më pak të zhvilluara, gjatë veprimeve që ato kryejnë në lidhje me financimin.

5. Një Mekanizëm që siguron burime financiare të mjaftueshme, të parashikueshme dhe në kohën e duhur, përkufizohet këtu. Mekanizmi mbështet shtetet Palë në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Konventë.

6. Mekanizmi përfshin:

(a) Fondin Global të Mjedisit; dhe

(b) Një program specifik ndërkombëtar që mbështet rritjen e kapaciteteve dhe asistencës teknike.

7. Fondi Global i Mjedisit siguron burime financiare të reja, të parashikueshme, të mjaftueshme dhe në kohë për përballimin e shpenzimeve në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente, siç është rënë dakord nga Konferenca e Palëve. Për qëllime të kësaj Konvente, Fondi Global i Mjedisit udhëzohet dhe i jep llogari Konferencës së Palëve. Konferenca e Palëve udhëzon strategjitë e përgjithshme, politikat, programet prioritare dhe të drejtën e aksesit dhe shfrytëzimit të burimeve financiare. Për më tepër, Konferenca e Palëve udhëzon në lidhje me listën treguese të kategorive të aktiviteteve që Fondi Global i Mjedisit mund të mbështesë. Fondi Global i Mjedisit siguron burimet për të përballuar shpenzimet e miratuara shtesë të përfitimeve globale mjedisore dhe shpenzimet e plota të miratuara të disa aktiviteteve lehtësuese.

8. Fondi Global Mjedisor duhet të marrë parasysh reduktimet e mundshme të mërkurit nga një aktivitet i propozuar në krahasim me kostot e tij, kur siguron burimet për një aktivitet.

9. Për qëllime të kësaj Konvente, Programi i përmendur në paragrafin 6 (b) do të operohet nën drejtimin dhe do t'i japë llogari Konferencës së Palëve. Në takimin e saj të parë Konferenca e Palëve vendos institucionin mbajtës të Programit, i cili duhet të jetë subjekt ekzistues dhe e udhëzon atë edhe për kohëzgjatjen e tij. Të gjitha Palët dhe aktorë të tjerë përkatës janë të ftuar që të sigurojnë në mënyrë vullnetare burimet financiare për Programin.

10. Konferenca e Palëve dhe subjektet që përbëjnë Mekanizmin bien dakord, në takimin e parë të Konferencës së Palëve, mbi masat për realizimin e paragrafëve të mësipërm.

11. Konferenca e Palëve rishikon, jo më vonë se në takimin e saj të tretë dhe më pas rregullisht, nivelin e financimit, drejtimin që Konferenca e Palëve u jep subjekteve të cilët janë besuar për operimin e Mekanizmit të ngritur sipas këtij Neni dhe efikasitetin e tyre, si dhe aftësinë e tyre për të adresuar nevojat në ndryshim të shteteve Palëve në zhvillim dhe Palëve me ekonomitë në tranzicion. Në bazë të këtij rishikimi merren masat e duhura për të përmirësuar efikasitetin e Mekanizmit.

12. Të gjitha Palët, brenda aftësive të tyre, janë të ftuara që të kontribuojnë për Mekanizmin. Mekanizmi inkurajon sigurimin e burimeve nga burime të tjera, duke përfshirë sektorin privat dhe përpiket që të shtojë këto burime për aktivitetet që mbështet.

Neni 14

Rritja e kapaciteteve, asistenca teknike dhe transferimi i teknologjisë

1. Palët bashkëpunojnë që të sigurojnë, brenda aftësive të tyre reciproke, rritjen e kapaciteteve dhe asistencën teknike ndaj shteteve Palë në zhvillim në kohën e duhur dhe siç duhet, në veçanti për Palët që janë vende më pak të zhvilluara ose ishuj të vegjël me Shtete në

zhvillim, dhe Palët me ekonomi në tranzicion, për t'i ndihmuar ato që të zbatojnë detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente.

2. Rritja e kapaciteteve dhe asistenca teknike sipas paragrafit 1 dhe Nenit 13 mund të sigurohet nëpërmjet masave rajonale, nën-rajonale dhe kombëtare, duke përfshirë qendrat rajonale dhe nën-rajonale ekzistuese, nëpërmjet mjeteve të tjera shumë-palëshe dhe dy-palëshe dhe nëpërmjet partneritetit, si dhe partneriteteve që përfshijnë sektorin privat. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me marrëveshje të tjera shumë-palëshe mjedisore në fushën e substancave kimike dhe mbetjeve duhet të kërkohen për rritjen e efikasitetit të asistencës teknike dhe dhënien e saj.

3. Shtetet Palë në zhvillim dhe Palët e tjera brenda aftësisë së tyre e të mbështetura nga sektori privat dhe aktorët e tjerë përkatës duhet të nxisin dhe lehtësojnë siç duhet, zhvillimin, transferimin, përhapjen, si dhe aksesin ndaj teknologjive të duhura mjedisore alternative e të përditësuara për shtetet Palë në zhvillim, në veçanti për shtetet më pak të zhvilluara dhe ishujt e vegjël me Shtete në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion, për të forcuar kapacitetin e tyre që të zbatojnë me efikasitet këtë Konventë.

4. Konferenca e Palëve, brenda takimit të saj të dytë dhe më pas rregullisht, dhe duke marrë parasysh parashtrimet e raportet e Palëve, përfshirë këtu ato të cilësuara në Nenin 21 dhe informacionin e ofruar nga aktorë të tjerë, duhet:

(a) Të marrë parasysh informacionin mbi iniciativat ekzistuese dhe progresin e bërë në lidhje me teknologjitë alternative;

(b) Të marrë parasysh nevojat e Palëve, veçanërisht të vendeve Palë në zhvillim, për teknologjitë alternative; dhe

(c) Të identifikojë sfidat me të cilat Palët janë përballur, veçanërisht vendet Palë në zhvillim, në transferimin e teknologjisë.

5. Konferenca e Palëve bën rekomandime se si mund të përmirësohet më tej rritja e kapaciteteve, asistenca teknike dhe transferimi i teknologjisë sipas këtij Neni.

Neni 15

Komiteti i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë

1. Një mekanizëm krijohet, duke përfshirë një Komitet si organ ndihmës i Konferencës së Palëve, për të nxitur zbatimin dhe kontrollin e pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat e kësaj Konvente. Mekanizmi, përfshirë Komitetin, ka karakter ndihmues dhe u kushton vëmendje të veçantë aftësive kombëtare përkatëse dhe rrethanave të Palëve.

2. Komiteti promovon zbatimin dhe kontrollon pajtueshmërinë me të gjitha dispozitat e kësaj Konvente. Komiteti shqyrton jo vetëm çështjet individuale por edhe ato sistemike të zbatimit dhe pajtueshmërisë. Gjithashtu ai bën rekomandime, sipas rastit, tek Konferenca e Palëve.

3. Komiteti përbëhet nga 15 anëtarë të caktuar nga Palët dhe të zgjedhur nga Konferenca e Palëve, duke marrë parasysh siç duhet përfaqësimin e barabartë gjeografik në bazë të pesë rajoneve të Kombeve të Bashkuara. Anëtarët e pare zgjidhen në takimin e parë të Konferencës së Palëve dhe më pas në përputhje me rregullat e procedurave të miratuara nga Konferenca e

Palëve sipas paragrafit 5. Anëtarët e Komitetit duhet të kenë aftësi në një fushë përkatëse të kësaj Konventë dhe të pasqyrojnë një balancë të duhur të njohurive.

4. Komiteti mund të shqyrtojë çështjet në bazë të:

- (a) Parashtrimeve me shkrim nga çdo Palë në lidhje me pajtueshmërinë e tyre;
- (b) Raporteve kombëtare në përputhje me Nenin 21; dhe
- (c) Kërkesave nga Konferenca e Palëve.

5. Komiteti harton rregullat e tij të procedurës, të cilat duhet të miratohen brenda takimit të dytë të Konferencës së Palëve. Konferenca e Palëve mund të miratojë kushte të tjera të referencës për Komitetin.

6. Komiteti bën të gjitha përpjekjet për të miratuar rekomandimet e tij me konsensus. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet me konsensus dhe nuk është arritur ndonjë konsensus, si zgjidhje e fundit, këto rekomandime duhet të miratohen me shumicë votash me tre të katërtat e anëtarëve të pranishëm në votim, në bazë të një kuorumi prej dy të tretave të anëtarëve.

Neni 16

Aspektet shëndetësore

1. Palët inkurajohen:

(a) Me pjesëmarrjen e sektorëve të shëndetit publik dhe sektorëve të tjerë të përfshirë, të nxisin zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve për të identifikuar dhe mbrojtur popullsinë në rrezik, veçanërisht popullsinë e cënueshme. Këtu mund të përfshihet miratimi i udhëzimeve shëndetësore me bazë shkencore në lidhje me ekspozimin ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij, përcaktimi i objektivave për reduktimin e ekspozimit ndaj mërkurit, nëse është e nevojshme, dhe edukimi i publikut;

(b) Të nxisin zhvillimin dhe zbatimin e programeve arsimore me bazë shkencore dhe programeve parandaluese për ekspozimin në punë ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij;

(c) Të nxisin shërbimet e duhura të kujdesit shëndetësor për parandalimin, trajtimin dhe kujdesin ndaj popullsisë së ndikuar nga ekspozimi ndaj mërkurit apo përbërësve të tij; dhe

(d) Të rrisin e forcojnë, siç duhet, kapacitetet institucionale dhe profesionale shëndetësore për parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe monitorimin e rreziqeve shëndetësore në lidhje me ekspozimin ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij.

2. Konferenca e Palëve, duke marrë parasysh çështjet ose aktivitetet në lidhje me shëndetin:

(a) Konsultohet dhe bashkëpunon me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Organizatën Botërore të Punës dhe organizata të tjera ndërqeveritare, nëse është e nevojshme; dhe

(b) Nxiti bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Organizatën Botërore të Punës dhe organizata të tjera ndërqeveritare, nëse është e nevojshme.

Neni 17**Shkëmbimi i Informacionit**

1. Çdo Palë lehtëson shkëmbimin e:

(a) Informacionit shkencor, teknik, ekonomik dhe ligjor në lidhje me mërkurin dhe përbërësit e tij, përfshirë edhe informacionin toksikologjik, ekotoksikologjik dhe të sigurisë;

(b) Informacionin rreth reduktimit ose eliminimit të prodhimit, përdorimit, tregtimit, emetimeve dhe çlirimeve të mërkurit dhe përbërësve të tij;

(c) Informacionin rreth alternativave të zbatueshme teknike dhe ekonomike për:

(i) Produktet me mërkur të shtuar;

(ii) Proceset e prodhimit ku përdoret mërkuri dhe përbërësit e tij; dhe

(iii) Aktivitetet dhe proceset që emetojnë ose çlirojnë mërkur ose përbërësit e tij;

duke përfshirë edhe informacionin rreth rreziqeve shëndetësore e mjedisore, dhe kostot ekonomike e sociale, si edhe përfitimet e këtyre alternativave; dhe

(d) Informacionin epidemiologjik në lidhje me pasojat shëndetësore si rrjedhojë e ekspozimit ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij, duke bashkëpunuar ngushtë me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe organizatat e tjera përkatëse, sipas rastit.

2. Palët mund të shkëmbejnë informacionin e përmendur në paragrafin 1 drejtpërdrejt, nëpërmjet Sekretariatit ose në bashkëpunim me organizatat e tjera përkatëse, përfshirë edhe sekretariatet e konventave mbi substancat kimike dhe mbetjet, sipas rastit.

3. Sekretariati lehtëson bashkëpunimin me organizatat e tjera përkatëse, përfshirë sekretariatet e marrëveshjeve mjedisore shumë-palëshe dhe nismat e tjera ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit të përmendur në këtë Nen. Përveç informacionit të dhënë nga Palët, ky informacion duhet të përfshijë informacione nga organizatat ndërqeveritare dhe jo-qeveritare me njohuri në fushën e mërkurit, dhe nga institucionet kombëtare e ndërkombëtare që kanë këto njohuri.

4. Çdo Palë duhet të caktojë një pikë kombëtare kontakti për shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Konvente, duke përfshirë edhe pëlqimin e Palëve importuese sipas Nenit 3.

5. Për qëllime të kësaj Konvente, informacioni mbi shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe mjedisit nuk duhet të konsiderohet si konfidencial. Palët që shkëmbejnë informacione të tjera në përputhje me këtë Konventë duhet të mbrojnë çdo informacion konfidencial që është rënë dakord reciprokisht.

Neni 18**Informimi publik, ndërgjegjësimi dhe arsimimi**

1. Çdo Palë brenda aftësive të saj promovon dhe lehtëson:

(a) Vënien e informacionit në dispozicion të publikut rreth:

(i) Ndikimeve shëndetësore dhe mjedisore të mërkurit dhe përbërësve të tij;

- (ii) Alternativave ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij;
 - (iii) Temave të identifikuara në paragrafin 1 të Nenit 17;
 - (iii) Rezultateve të kërkimeve shkencore, zhvillimeve dhe monitorimeve të aktiviteteve sipas Nenit 19; dhe
 - (v) Aktiviteteve për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Konvente;
 - (b) Arsimimi, formimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me pasojat e ekspozimit ndaj mërkurit dhe përbërësve të tij për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin në bashkëpunim me organizatat përkatëse ndër-qeveritare dhe jo-qeveritare dhe popullsinë e cënueshme, sipas rastit.
2. Çdo Palë përdor mekanizmat ekzistues ose i jep rëndësi zhvillimit të mekanizmave si çlirimi i ndotësve dhe regjistrave të transferimit, nëse është e zbatueshme, për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit rreth vlerësimeve të sasive vjetore të mërkurit dhe përbërësve të tij, që emetohen, çlirohen ose asgjësohen nëpërmjet aktiviteteve të njerëzve.

Neni 19

Kërkim, zhvillim dhe monitorim

1. Duke marrë parasysh rrethanat dhe aftësitë e tyre përkatëse, Palët përpiqen që të bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe përmirësuar:
- (a) Inventarët e përdorimit, konsumimit dhe emetimet antropogjenike në ajër, dhe çlirimet në ujë e tokë të mërkurit dhe përbërësve të tij;
 - (b) Modelimin dhe monitorimin përfaqësues gjeografik të niveleve të mërkurit dhe përbërësve të tij në popullsinë e cënueshme dhe në elementet mjedisore, përfshirë elementet biotike të mjedisit si peshku, gjitarët ujorë, breshkat e detit dhe shpendët, si dhe bashkëpunimin për mbledhjen dhe shkëmbimin e mostrave përkatëse dhe të duhura;
 - (c) Vlerësimet e pasojave të mërkurit dhe përbërësve të tij në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis, së bashku me pasojat sociale, ekonomike dhe kulturore, veçanërisht në lidhje me popullsinë e cënueshme;
 - (d) Metodologjitë e harmonizuara për aktivitetet e ndërmarra sipas nën-paragrafëve (a), (b) dhe (c);
 - (e) Informacionin rreth ciklit mjedisor, transportit (përfshirë transportin në distancë të largët dhe depozitim), transformimin dhe destinacionin e mërkurit dhe përbërësve të tij në një shumëllojshmëri ekosistemesh, duke marrë parasysh siç duhet dallimin ndërmjet emetimeve antropogjenike dhe natyrale dhe çlirimet e mërkurit dhe rimobilizimin e mërkurit nga depozitimet e hershme;
 - (f) Informacionin rreth tregtisë dhe tregimit të mërkurit e përbërësve të tij dhe produkteve me mërkur të shtuar; dhe
 - (g) Informacionin dhe kërkimet mbi disponueshmërinë teknike dhe ekonomike të produkteve e proceseve pa mërkur dhe mbi teknikat më të mira të disponueshme, si dhe praktikave më të mira mjedisore për të reduktuar dhe monitoruar emetimet e çlirimet e mërkurit dhe përbërësve të tij.

2. Sipas rastit, Palët punojnë mbi rrjetet ekzistuese të monitorimit dhe programet e kërkimit për të ndërmarrë aktivitetet e identifikuara në paragrafin 1.

Neni 20

Planet e zbatimit

1. Pas një vlerësimi fillestar secila Palë mund të zhvillojë dhe ekzekutojë planin e zbatimit duke marrë parasysh rrethanat lokale, për përmbushjen e detyrimeve të kësaj Konvente. Çdo plan i tillë duhet t'i transmetohet Sekretariatit sapo të hartohet.

2. Çdo Palë mund të rishikojë dhe përditësojë planin e saj të zbatimit, duke marrë parasysh rrethanat lokale dhe duke iu referuar udhëzimeve të Konferencës së Palëve dhe ndonjë udhëzimi tjetër përkatës.

3. Palët duhet të konsultojnë aktorët kombëtarë për të lehtësuar zhvillimin, zbatimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të tyre të zbatimit gjatë kryerjes së punës të referuar në paragrafët 1 dhe 2.

4. Palët mund të bashkërendojnë gjithashtu për planet rajonale për të lehtësuar zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 21

Raportimi

1. Çdo Palë i raporton Konferencës së Palëve, nëpërmjet Sekretariatit, mbi masat që ka marrë për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente dhe mbi efikasitetin e këtyre masave dhe sfidat e mundshme në përmbushjen e objektivave të Konventës.

2. Çdo Palë përfshin në raportimin e saj informacionin e kërkuar sipas Nenit 3, 5, 7, 8 dhe 9 të kësaj Konvente.

3. Në takimin e saj të parë, Konferenca e Palëve vendos mbi kohën dhe formatin e raportit që Palët duhet të ndjekin, duke marrë parasysh dëshirën e bashkërendimit të raportimit me konventat e tjera përkatëse mbi substancat dhe mbetjet kimike.

Neni 22

Vlerësimi i efikasitetit

1. Konferenca e Palëve vlerëson efikasitetin e kësaj Konvente, duke filluar jo më vonë se gjashtë vjet nga data e hyrjes në fuqi e Konventës dhe më pas periodikisht në intervale kohe të caktuara nga ajo.

2. Për të lehtësuar vlerësimin, Konferenca e Palëve, në takimin e saj të parë, fillon vendosjen e masave për t'u pajisur me të dhëna të krahasueshme monitoruese mbi praninë dhe lëvizjen e merkurit dhe përbërësve të tij në mjedis, si edhe tendencat e niveleve të merkurit e përbërësve të tij të vëzhguara në elementet biotike të mjedisit dhe popullsinë e cënueshme.

3. Vlerësimi kryhet në bazë të informacionit të disponueshëm shkencor, mjedisor, teknik, financiar dhe ekonomik, përfshirë:

- (a) Raportet dhe informacionin tjetër monitorues të ofruar nga Konferenca e Palëve në përputhje me paragrafin 2;
- (b) Raportet e paraqitura në përputhje me Nenin 21;
- (c) Informacione dhe rekomandime të ofruara në përputhje me Nenin 15; dhe
- (d) Raporte dhe informacione të tjera përkatëse rreth përdorimit të ndihmës financiare, transferimit teknologjik dhe masave të marra për rritjen e kapaciteteve sipas kësaj Konvente.

Neni 23

Konferenca e Palëve

1. Për këtë qëllim krijohet një Konferencë e Palëve.
2. Mbledhja e parë e Konferencës së Palëve do të thirret nga Drejtori Ekzekutiv i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas, mbledhjet e zakonshme të Konferencës së Palëve zhvillohen në periudha kohore të rregullta që përcaktohen nga Konferenca.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve zhvillohen në periudha kohore të tjera, siç mund të çmohet e nevojshme nga Konferenca ose me kërkesën me shkrim të një Pale, me kusht që kërkesa e cila brenda gjashtë muajve i komunikohet Palëve nga Sekretariati, të mbështetet të paktën nga një e treta e Palëve.
4. Konferenca e Palëve bie dakord dhe miraton me konsensus në mbledhjen e saj te parë rregullat e procedurës dhe rregullat financiare për vete dhe për ndonjë organ ndihmës, si dhe dispozitat financiare që rregullojnë funksionimin e Sekretariatit
5. Konferenca e Palëve mban nën shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm zbatimin e kësaj Konvente. Ajo përmbush funksionet që i janë caktuar nga Konventa dhe për këtë qëllim:
 - (a) Krijon organe ndihmëse që i çmon të nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente;
 - (b) Bashkëpunon, sipas rastit, me organizata ndërkombëtare kompetente dhe organe ndërqeveritare dhe joqeveritare;
 - (c) Rishikon rregullisht informacionin e vënë në dispozicion të saj dhe të Sekretariatit në përputhje me Nenin 21;
 - (d) Merr parasysh çdo rekomandim që i është paraqitur nga Komiteti i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë;
 - (e) Merr parasysh dhe ndërmerr çdo veprim tjetër shtesë që mund të kërkohej për të arritur objektivat e kësaj Konvente; dhe
 - (f) Rishikon Shtojcat A dhe B në përputhje me Nenin 4 dhe Nenin 5.
6. Kombet e Bashkuara, agjencitë e tyre të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe çdo shtet jo palë në këtë Konventë, mund të përfaqësohen në mbledhjet e Konferencës së Palëve si vëzhgues. Çdo organ ose agjenci, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose joqeveritare, i kualifikuar në çështjet e trajtuara në këtë

Konventë dhe që ka informuar Sekretariatit mbi dëshirën për t'u përfaqësuar në mbledhjen e Konferencës së Palëve si vëzhgues, mund të pranohet nëse të paktën një e treta e Palëve të pranishme nuk e kundërshton këtë. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve u nënshtrohet rregullave të procedurës të miratuara nga Konferenca e Palëve.

Neni 24

Sekretariati

1. Për këtë qëllim ngrihet Sekretariati.
2. Funksionet e Sekretariatit janë:
 - (a) Të organizojë mbledhjet e Konferencës së Palëve dhe organeve ndihmëse të saj dhe t'u ofrojë atyre shërbimet e kërkuara;
 - (b) Të lehtësojë ndihmën për Palët, veçanërisht për Palët në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion, sipas kërkesës, në zbatimin e Konventës.
 - (c) Të sigurojë bashkërendimin e nevojshëm me sekretariatet e organizmave të tjera përkatëse ndërkombëtare, në veçanti me konventa të tjera mbi substancat dhe mbetjet kimike;
 - (d) Të ndihmojë Palët në shkëmbimin e informacionit në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente;
 - (e) Të përgatisë dhe vërë në dispozicion të Palëve, raporte periodike të bazuara në informacionin e marrë në përputhje me Nenet 15 dhe 21 dhe informacion tjetër të disponueshëm;
 - (f) Të hyjë në marrëveshje të tilla administrative dhe kontraktuale që mund të nevojiten për përmbushjen efektive të funksioneve të tij, sipas udhëzimeve të përgjithshme të Konferencës së Palëve; dhe
 - (g) Të përmbushë funksionet e tjera të sekretariatit të specifikuar në këtë Konventë dhe funksionet e tjera që mund të jenë përcaktuar nga Konferenca e Palëve.
3. Funksionet e sekretariatit për këtë Konventë përmbushen nga Drejtori Ekzekutiv i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, përveç kur Konferenca e Palëve mund të vendosë me tri të katërtat e shumicës së Palëve të pranishme dhe që votojnë, për t'i besuar funksionet e sekretariatit një ose me shumë organizatave të tjera kompetente ndërkombëtare
4. Konferenca e Palëve, duke u konsultuar me organet e duhura ndërkombëtare, mund të parashikojë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet Sekretariatit dhe sekretariateve të tjerë të konventave mbi substancat dhe mbetjet kimike. Konferenca e Palëve, duke u konsultuar me organet e duhura ndërkombëtare, mund të ofrojë udhëzime të tjera për këtë çështje.

Neni 25**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët zgjidhin çdo mosmarrëveshje midis tyre për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të kësaj Konvente nëpërmjet negocimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre.
2. Gjatë ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në çdo kohë të mëpasshme, një Palë që nuk është organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të deklarojë në një instrument me shkrim të dorëzuar tek Depozitari se, për sa i përket ndonjë mosmarrëveshjeje mbi interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente, ajo pranon një ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve si të detyrueshme në lidhje me çdo Palë që pranon të njëjtin detyrim:
 - (a) Arbitrazhin në përputhje me procedurën e përcaktuar në Pjesën I të Shtojcës E;
 - (b) Paraqitjen e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.
3. Një palë që është organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të bëjë një deklaratë me efekt të njëjtë në lidhje me arbitrazhin në përputhje me paragrafin 2.
4. Një deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin 2 apo 3 mbetet në fuqi brenda afatit të saj në përputhje me afatet ose deri në tre muaj pasi njoftimi me shkrim për revokimin e saj të jetë depozituar te Depozitari.
5. Skadimi i afatit të një deklarate, njoftimi për revokim ose një deklaratë të re nuk ndikon në asnjë mënyrë në procedimet e mbetura pezull para një gjykate arbitrazhi ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, nëse palët e mosmarrëveshjes nuk bien dakord ndryshe.
6. Nëse palët e një mosmarrëveshjeje nuk kanë pranuar mjetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në pajtim me paragrafin 2 ose 3, dhe nëse nuk kanë mundur ta zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet mënyrave të përmendura në paragrafin 1 brenda dymbëdhjetë muajve pas njoftimit nga një Palë për tjetrën se ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet tyre, mosmarrëveshja paraqitet tek një komision pajtimi me kërkesë të çdo pale të mosmarrëveshjes. Për pajtimin zbatohet procedura e përcaktuar në Pjesën II të Shtojcës E në përputhje me këtë Nen.

Neni 26**Amendamentet e Konventës**

1. Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga secila Palë.
2. Amendamentet e kësaj Konvente miratohen në mbledhjen e Konferencës së Palëve. Teksti i çdo amendamenti të propozuar i komunikohet Palëve nga Sekretariati të paktën gjashtë muaj para mbledhjes në të cilën ai amendament është propozuar për miratim. Sekretariati i komunikon gjithashtu amendamentin e propozuar nënshkruesve të kësaj Konvente dhe për informacion Depozitarit.
3. Palët bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje me konsensus për çdo amendament të propozuar të kësaj Konvente. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për arritjen e

konsensusit dhe nuk arrihet marrëveshja, si zgjidhje e fundit amendamenti miratohet me shumicë votash prej tre të katërtave të palëve të pranishme që votojnë në mbledhje.

4. Një amendament i miratuar i komunikohet nga Depozitari të gjitha Palëve për ratifikim, pranim apo miratim.

5. Ratifikimi, pranimi ose miratimi i një amendamenti njoftohet me shkrim nga Depozitari. Një amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 hyn në fuqi për Palët që e kanë pranuar atë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga të paktën tri të katërtat e Palëve, të cilat ishin Palë në kohën e miratimit të amendamentit. Më pas, amendamenti hyn në fuqi për çdo Palë tjetër në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën ajo Palë depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit apo miratimit të amendamentit.

Neni 27

Miratimi dhe ndryshimi i shtojcave

1. Shtojcat e kësaj Konvente formojnë pjesë përbërëse të saj dhe, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë ndaj kësaj Konvente përbën njëkohësisht një referencë ndaj çdo shtojce të saj.

2. Çdo shtojcë plotësuese e miratuar pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kufizohet tek çështjet procedurale, shkencore, teknike apo administrative.

3. Procedura e mëposhtme zbatohet për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave plotësuese të kësaj Konvente:

(a) Shtojcat plotësuese propozohen dhe miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafët 1-3 të Nenit 26;

(b) Çdo palë që nuk mund të pranojë një shtojcë plotësuese njofton me shkrim Depozitarin brenda një viti nga data e komunikimit të miratimit të shtojcës plotësuese nga Depozitari. Depozitari njofton menjëherë pa vonesë të gjitha Palët mbi marrjen e një njoftimi të tillë. Një Palë mund të njoftojë me shkrim në çdo kohë Depozitarin se e tërheq një njoftim të mëparshëm të mos-pranimit në lidhje me shtojcën plotësuese, dhe për rrjedhojë shtojca hyn në fuqi për atë Palë sipas nënparagrafit (c); dhe

(c) Me kalimin e afatit njëvjeçar pas datës së komunikimit nga Depozitari të miratimit të një shtojce plotësuese, shtojca hyn në fuqi për të gjitha Palët që nuk kanë dorëzuar një njoftim mos-pranim në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit (b).

4. Propozimi, miratimi dhe hyrja në fuqi e amendamenteve të shtojcave të kësaj Konvente i nënshtrohen procedurave të njëjta si për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave plotësuese të Konventës, përveç kur një amendament i një shtojce nuk hyn në fuqi në lidhje me ndonjë Palë që ka bërë një deklaratë në lidhje me amendamentin e shtojcave në përputhje me paragrafin 5 të Nenit 30. Në këtë rast, çdo amendament i tillë hyn në fuqi për këtë Palë në ditën e nëntëdhjetë pas datës që ka depozituar tek Depozitari instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit në lidhje me këtë amendament.

5. Nëse një shtojcë plotësuese ose një amendament i një shtojce lidhet me amendimin e kësaj Konvente, shtojca plotësuese apo amendamenti nuk hyjnë në fuqi deri në kohën kur amendamenti i kësaj Konvente të hyjë në fuqi.

Neni 28**E drejta e votës**

1. Çdo palë e kësaj Konvente ka një votë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2 më poshtë;
2. Një organizatë rajonale e integritit ekonomik, për çështjet brenda kompetencës së saj, ushtron të drejtën e saj të votës me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të saj anëtare që janë Palë në këtë Konventë. Një organizatë e tillë nuk ushtron të drejtën e saj të votës nëse ndonjë Shtet anëtar i saj ushtron të drejtën për të votuar dhe anasjelltas.

Neni 29**Nënshkrimi**

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në Kumamoto, Japoni, nga të gjitha Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik më 10 dhe 11 tetor 2013, dhe më pas në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri më 9 tetor 2014.

Neni 30**Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi**

1. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik. Ajo do të jetë e hapur për aderim nga Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik nga dita pas datës në të cilën kjo Konventë mbyllet për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, miratimit, aprovimit apo aderimin depozitohen tek Depozitari.
2. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik që bëhet Palë e kësaj Konvente pa ndonjë prej Shteteve anëtare të saj si Palë, i përmbahet të gjitha detyrimeve sipas Konventës. Në rastin e organizatave të tilla, ku një ose më shumë prej Shteteve anëtare të saj janë Palë të kësaj Konvente, organizata dhe Shtetet anëtare të saj vendosin për përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës. Në raste të tilla, organizata dhe Shtetet anëtare nuk kanë të drejtën të ushtrojnë njëkohësisht të drejtat sipas Konventës.
3. Në instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një organizatë rajonale e integritit ekonomik deklaron shkallën e saj të kompetencës në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë. Çdo organizatë e tillë njofton gjithashtu Depozitarin, i cili më pas informon Palët për çdo modifikim përkatës në shtrirjen e kompetencave të saj.
4. Çdo Palë ose organizatë rajonale e integritit ekonomik inkurajohet të dorëzojë tek Sekretariati në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të Konventës, informacionin mbi masat që ka marrë për zbatimin e Konventës.
5. Në instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, çdo Palë mund të deklarojë që çdo amendament i një shtojce hyn në fuqi vetëm pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit në lidhje me të.

Neni 31**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.
2. Për çdo Shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik që ratifikon, pranon ose miraton këtë Konventë apo aderon në të pas depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga ky Shtet apo organizatë rajonale e integritit ekonomik të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.
3. Për qëllime të paragrafit 1 dhe 2, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk konsiderohet si shtojcë e instrumenteve të depozituara nga Shtetet anëtare të asaj organizate.

Neni 32**Rezervat**

Kësaj Konvente nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 33**Tërheqja**

1. Në çdo kohë, pas tre vjetësh pas datës në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi për një Palë, ajo Palë mund të tërhiqet nga Konventa duke i dhënë Depozitarit njoftim me shkrim.
2. Çdo tërheqje e tillë hyn në fuqi një vit pas marrjes nga Depozitari të njoftimit për tërheqjen ose në një datë të mëvonshme që mund të caktohet në njoftimin e tërheqjes.

Neni 34**Depozitari**

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është Depozitari i kësaj Konvente.

Neni 35**Tekstet Autentike**

Origjinali e kësaj Konvente, ku tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle të të cilit janë njëlloj autentike, depozitohen te Depozitari.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, të autorizuar me ligj për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.
Hartuar në Kumamoto, Japoni, më dhjetë tetor dy mijë e trembëdhjetë.

Shtojca A

Produkte me mërkur të shtuar

Produktet e mëposhtme janë të përjashtuara nga kjo Shtojcë:

- (a) Produktet e nevojshme për mbrojtjen civile dhe për përdorime ushtarake;
- (b) Produkte për kërkime shkencore, kalibrimin e instrumentimit, për përdorim si standard referimi;
- (c) Çelësat dhe reletë, llambat me katodë të ftohtë fluoreshente dhe llambat me elektrodë të jashtme fluoreshente (CCFL dhe EEFL) për reklama elektronike dhe aparate matëse, nëse zëvendësimi i tyre me alternativa pa mërkur nuk është i realizueshëm;
- (d) Produktet e përdorura në praktikatat tradicionale ose fetare; dhe
- (e) Vaksinat që përmbajnë tiomersal si përbërës.

Pjesa I: Produktet që i nënshtrohen Nenit 4, paragrafi 1

Produkte me mërkur të shtuar	Data pas së cilës prodhimi, importimi ose eksportimi i produktit nuk do të lejohet (data e heqjes nga përdorimi)
Bateritë, përveç baterive rrethore argjendi oksid zinku me një përqendrim mërkuri < 2% dhe baterive rrethore pneumatike zinku me një përqendrim mërkuri < 2%	2020
Çelësat dhe reletë, përveç rezistencave me saktësi të lartë dhe urave matëse të humbjes dhe çelësave të frekuencës së radios me frekuencë të lartë dhe reletë në instrumentet e kontrollit dhe monitorimit me një përqendrim maksimal të mërkurit prej 20mg për urë, çelës apo rele.	2020
Llamba fluoreshente kompakte (CFLs) për ndriçim të përgjithshëm ≤ 30 vat me një përqendrim mërkuri mbi 5 mg për kandelë të llambës.	2020
Llamba fluoreshente lineare (LFLs) për ndriçim të përgjithshëm: (a) Me tre shtresa fosfori <60 vat me një përqendrim mërkuri mbi 5 mg për llambë; (b) Me fosfor halofosfat ≤ 40 vat me një përqendrim mërkuri mbi 10 mg për llambë	2020
Llamba me avull mërkuri me voltazh të lartë (HPMV) për qëllime të përgjithshme ndriçimi	2020
Mërkuri në llambat me katodë të ftohtë fluoreshente dhe llambat me elektrodë të jashtme fluoreshente (CCFL dhe EEFL) për reklama elektronike: (a) rreze të shkurtër (≤ 500 mm) me një përqendrim mërkuri mbi 3.5 mg për llambë	2020

Produkte me mërkur të shtuar	Data pas së cilës prodhimi, importimi ose eksportimi i produktit nuk do të lejohet (data e heqjes nga përdorimi)
(b) rreze të mesme (> 500 mm dhe $\leq 1\,500$ mm) me një përqendrim mërkuri mbi 5 mg për llambë (c) rreze të gjatë ($> 1\,500$ mm) me një përqendrim mërkuri mbi 13 mg për llambë	
Produkte kozmetike (me një përqendrim mërkuri mbi 1ppm), si për shembull sapunët dhe kremrat e fytyrës, duke mos përfshirë produktet kozmetike për zonën e syrit ku mërkuri përdoret si përbërës dhe nuk ka asnjë përbërës zëvendësues të sigurt dhe të efektshëm ^{1/}	2020
Pesticidet, biocidet dhe antispetikët topikalë	2020
Pajisjet e mëposhtme matëse jo-elektronike përveç pajisjeve matëse jo-elektronike të instaluar në pajisje me përmasa të mëdha ose ato që përdoren për matje me precizion të lartë, ku nuk ka alternativë tjetër të përshtatshme pa mërkur: (a) barometra; (b) higrometra; (c) manometra; (d) termometra; (e) sfigmomanometra.	2020

^{1/} Qëllimi është të mos mbulohen produktet kozmetike, sapunët apo kremrat e kontaminuara me gjurmë mërkuri.

Pjesa II: Produkte që i nënshtrohen Nenit 4, paragrafit 3

Produkte me mërkur të shtuar	Dispozitat
Amalgami dentar	Masat që një Palë do të marrë për të heqjen nga përdorimi të amalgamit dentar duhet të marrin parasysh rrethanat lokale të Palës dhe udhëzimet përkatëse ndërkombëtare, si dhe duhet të përfshijnë dy ose më shumë nga masat e listës së mëposhtme: (i) Vendosjen e objektivave kombëtare që kanë si qëllim parandalimin e kariesit dentar dhe promovimin e shëndetit, duke reduktuar si rrjedhojë nevojën për rikonstruksionin e dhëmbëve; (ii) Vendosjen e objektivave kombëtare që kanë si qëllim reduktimin e përdorimit të amalgamit dentar; (iii) Promovimin e përdorimit të alternativave të tjera efikase për nga kostoja dhe pikëpamja klinike për rikonstruksionin e dhëmbëve;

	(iv) Promovimin e kërkimeve dhe prodhimin e materialeve cilësore pa mërkur për rikonstrukcionin e dhëmbëve; (v) Inkurajimin e organizatave përfaqësuese profesionale dhe shkollave dentare për të edukuar dhe trajnuar profesionistët dhe studentët dentarë për përdorimin e alternativave pa mërkur për rikonstrukcionin e dhëmbëve dhe promovimin e praktikave më të mira menaxhuese; (vi) Mos-mbështetjen e programeve dhe politikave të sigurimit që përkrahin përdorimin e amalgamit dentar sesa rikonstrukcionet e dhëmbëve pa mërkur; (vii) Mbështetjen e politikave dhe programeve të sigurimit që mbështesin përdorimin e alternativave cilësore sesa amalgamin dentar për rikonstrukcionin e dhëmbëve; (viii) Kufizimin e përdorimit të amalgamit dentar në formën e tij të enkapsuluar; (ix) Promovimin e përdorimit të praktikave më të mira mjedisore për të reduktuar çlirimin e mërkurit dhe përbërësve të tij në ujë dhe tokë.
--	--

Shtojca B**Proceset e prodhimit ku përdoret mërkuri ose përbërësit e tij****Pjesa I: Procese që i nënshtrohen Nenit 5, paragrafi 2**

1.

Proceset e prodhimit që përdorin mërkurin ose përbërësit e tij	Data e heqjes nga përdorimi
Prodhimi Klor-alkalik	2025
Prodhimi i acetaldehidit ku mërkuri ose përbërësit e tij përdoren si katalizator	2018

Pjesa II: Procese që i nënshtrohen Nenit 5, paragrafi 3

Procese që përdorin merkurin	Dispozita
Prodhimi i monomerit të vinil-kloridit	Masat që do të merren nga Palët duhet të përfshijnë por të mos kufizohen në: (i) Reduktimin e përdorimit të merkurit në lidhje me prodhimin për njësi me 50 për qind deri në vitin 2020 kundrejt përdorimit të vitit 2010; (ii) Promovimin e masave për të reduktuar vartësinë ndaj merkurit për nxjerrjen parësore të mineraleve; (iii) Marrjen e masave për të reduktuar emetimet dhe çlirimet e merkurit në mjedis; (iv) Mbështetjen e kërkimeve dhe zhvillimeve në lidhje me katalizatorët dhe proceset pa merkur; (v) Moslejimin e përdorimit të merkurit pesë vjet pas datës kur Konferenca e Palëve vendos që katalizatorët pa merkur në bazë të proceseve ekzistuese, janë bërë të realizueshme teknikisht dhe ekonomikisht; (vi) Raportimin tek Konferenca e Palëve rreth përpjekjeve për të zhvilluar dhe/ose identifikuar alternativa dhe heqjen nga përdorimi të merkurit në përputhje me Nenin 21.
Sodium ose Potasium Metilat ose Etilat	Masat që do të merren nga Palët duhet të përfshijnë por të mos kufizohen në: (i) Masa për reduktimin e përdorimit të merkurit duke synuar heqjen nga përdorimi sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda 10 vjetëve nga hyrja në fuqi e Konventës; (ii) Reduktimin e emetimeve dhe çlirimeve për sa i përket prodhimit për njësi me 50 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me vitin 2010; (iii) Ndalimin e përdorimit të merkurit të ri në nxjerrjen parësore të mineraleve; (iv) Mbështetjen për kërkime dhe zhvillime në lidhje me proceset pa merkur; (v) Moslejimin e përdorimit të merkurit pesë vjet pas datës kur Konferenca e Palëve vendos që proceset pa merkur janë bërë të realizueshme teknikisht dhe ekonomikisht; (vi) Raportimin tek Konferenca e Palëve rreth përpjekjeve për të zhvilluar dhe/ose identifikuar alternativa dhe heqjen nga përdorimi të merkurit në përputhje me nenin 21.

Prodhimi i poliuretanëve duke përdorur katalizatorë që përmbajnë merkur	Masat që do të merren nga Palët duhet të përfshijnë por të mos kufizohen në: (i) Masat për reduktimin e përdorimit të merkurit, duke synuar heqjen nga përdorimi sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda 10 vjetëve nga hyrja në fuqi e Konventës; (ii) Marrjen e masave për të reduktuar varësinë ndaj merkurit për nxjerrjen parësore të mineraleve; (iii) Marrjen e masave për të reduktuar emetimet dhe çlirimet e merkurit në mjedis; (iv) Mbështetjen e kërkimeve dhe zhvillimeve në lidhje me katalizatorët dhe proceset pa merkur; (v) Raportimin tek Konferenca e Palëve rreth përpjekjeve për të zhvilluar dhe/ose identifikuar alternativa dhe heqjen nga përdorimi të merkurit në përputhje me Nenin 21. Paragrafi 6 i Nenit 5 nuk zbatohet për këtë proces prodhimi.
---	--

Shtojca C

Nxjerrja artizanale dhe në shkallë të vogël e mineralit të arit

Planet kombëtare të veprimit

1. Çdo Palë që i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 3 të Nenit 7 duhet të përfshijë në planin e saj kombëtar të veprimit:

- (a) Objektivat kombëtare dhe qëllimet e reduktimit;
- (b) Veprimet për të eliminuar:
 - (i) Amalgamimin e plotë të xeherorit;
 - (ii) Djegien në vend të hapur të amalgamit apo amalgamit të përpunuar;
 - (iii) Djegien e amalgamit në zona rezidenciale; dhe
 - (iv) Filtrimin e cianidit në sediment, xeherorë ose minerale sterile, të cilëve u është shtuar mërkur pa hequr më parë mërkurin;
- (c) Hapat për të lehtësuar formalizimin ose rregullimin e sektorit të nxjerrjes artizanale dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit;
- (d) Llogaritjet bazë të sasive të mërkurit të përdorur dhe praktikat që përdoren në nxjerrjen dhe përpunimin artizanal e në shkallë të vogël të mineralit të arit brenda territorit të saj;
- (e) Strategjitë për promovimin dhe reduktimin e emetimeve e çlirimeve, dhe ekspozimit ndaj mërkurit në nxjerrjen dhe përpunimin artizanal dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit, duke përfshirë metoda pa mërkur;
- (f) Strategjitë për menaxhimin e tregtisë dhe parandalimin e ndërfutjen e mërkurit dhe përbërësve të tij, si nga burimet e huaja ashtu edhe ato vendase për t'u përdorur në nxjerrjen dhe përpunimin artizanal dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit;
- (g) Strategjitë për përfshirjen e aktorëve në zbatimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të planit kombëtar të veprimit;
- (h) Një strategji të shëndetit publik për ekspozimin ndaj mërkurit të minatorëve të minierave artizanale dhe të një shkalle të vogël të nxjerrjes së mineralit të arit dhe komunitetit të tyre. Kjo strategji duhet të përfshijë, ndër të tjera, mbledhjen e të dhënave shëndetësore, trajnimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet mjediseve shëndetësore;
- (i) Strategjitë për të parandaluar ekspozimin e popullsisë së cenueshme, në veçanti fëmijët dhe gratë e moshës riprodhuese, veçanërisht gratë shtatzëna, ndaj mërkurit që përdoret në nxjerrjen artizanale dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit;
- (j) Strategjitë për shpërndarjen e informacionit tek minatorët dhe komunitetet e prekura nga nxjerrja artizanale dhe në shkallë të vogël e mineralit të arit
- (k) Axhendën për zbatimin e planit kombëtar të veprimit.

2. Çdo Palë mund të përfshijë në planin e saj të veprimit, strategji të tjera për të arritur objektivat e saj, përfshirë përdorimin ose prezantimin e standardeve për nxjerrjen artizanale dhe në shkallë të vogël të mineralit të arit pa përdorur mërkurin dhe mekanizma të bazuara në treg ose mjetet e marketingut.

Shtojca D

Lista e pikës së burimeve të emetimit të mërkurit dhe përbërësve të tij në atmosferë

Kategoria e pikë burimit:

Termocentrale me qymyr;

Kaldaja industriale me qymyr;

Proceset e shkrirjes dhe pjekjes gjatë prodhimit të metaleve jo-ferroze;^{1/}

Objektet e djegies së mbetjeve;

Objektet e prodhimit të klinkerit të çimentos.

^{1/} Për qëllim të kësaj Shtojce, “metale-jo ferroze” u referohen plumbit, zinkut, bakrit dhe arit industrial.

Shtojca E

Procedurat e Arbitrazhit dhe Pajtimit

Pjesa I: Procedura e Arbitrazhit

Procedura e arbitrazhit për qëllime të paragrafit 2 (a) të Nenit 25 të kësaj Konvente, është si më poshtë:

Neni 1

1. Një nga palët mund të bëjë rekurs në arbitrazh në përputhje me nenin 25 të kësaj Konventës, duke njoftuar me shkrim palën ose palët e tjera të mosmarrëveshjes. Njoftimi shoqërohet me një deklaratë të kërkesë padisë, bashkë me dokumente të tjera mbështetëse. Ky njoftim cilëson objektin e çështjes për arbitrazh, duke përfshirë në veçanti nenet e kësaj Konvente, interpretimi apo zbatimimi i të cilave janë në diskutim.

2. Pala paditëse njofton Sekretariatën që palët i janë drejtuar arbitrazhit në lidhje me një mosmarrëveshje sipas Nenit 25 të kësaj Konvente. Njoftimi me shkrim i palës paditëse shoqërohet me deklaratën e kërkesë padisë dhe dokumentet e tjera mbështetëse të përmendura në paragrafin 1 më lart. Sekretariati i përcjell informacionin e marrë të gjitha Palëve.

Neni 2

1. Në rast të një mosmarrëveshje që paraqitet për arbitrazh në përputhje me Nenin 1 më lart, caktohet një gjykatë arbitrazhi. Ajo përbëhet nga tre anëtarë

2. Secila palë e mosmarrëveshjes cakton një arbitër dhe të dy arbitrat e zgjedhur nga palët caktojnë me marrëveshje një arbitër të tretë, i cili do të jetë Kryetar i gjykatës. Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet më shumë se dy palëve, palët me interes të përbashkët caktojnë bashkërisht me marrëveshje një arbitër. Kryetari i gjykatës nuk duhet të jetë shtetas i njërës prej palëve të mosmarrëveshjes, as nuk duhet të ketë vendbanimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e njërës prej palëve dhe as të jetë i punësuar prej tyre apo të ketë shqyrtuar çështjen në ndonjë cilësi tjetër.

3. Çdo vend bosh plotësohet sipas mënyrës së parashikuar për emërimin fillestar.

Neni 3

1. Nëse njëra nga palët në mosmarrëveshje nuk cakton një arbitër brenda dy muajve nga data në të cilën pala e paditur merr njoftimin e arbitrazhit, pala tjetër mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të bëjë caktimin e arbitrit brenda një periudhe të mëtijshme dymujore.

2. Nëse Kryetari i gjykatës së arbitrazhit nuk është caktuar brenda dy muajve nga data e caktimit të arbitrit të dytë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të caktojë Kryetarin e gjykatës brenda një periudhe dy mujore, me kërkesën e një Pale.

Neni 4

Gjykata e arbitrazhit merr vendimet në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

Përveç kur palët e mosmarrëveshjes bien dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit vendos rregullat e veta të procedurës.

Neni 6

Gjykata e arbitrazhit mund të rekomandojë me kërkesën e njërës prej palëve, masa të nevojshme të përkohshme mbrojtëse.

Neni 7

Palët e mosmarrëveshjes lehtësojnë punën e gjykatës së arbitrazhit dhe në veçanti, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre:

(a) i japin asaj të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe shërbimet përkatëse; dhe

(b) t'i mundësojnë asaj, nëse është e nevojshme, të thërrasë dëshmitarë ose ekspertë dhe të marrë dëshmitë e tyre.

Neni 8

Palët e mosmarrëveshjes dhe arbitrat kanë detyrimin për të ruajtur fshehtësinë e çdo informacioni apo dokumenti që marrin në mirëbesim gjatë procedimeve të gjykatës së arbitrazhit.

Neni 9

Në rast se Gjykata e Arbitrazhit vendos ndryshe për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes, shpenzimet e Gjykatës ndahen në mënyrë të barabartë nga palët e mosmarrëveshjes. Gjykata regjistron të gjitha shpenzimet dhe i dërgon palëve një raport përfundimtar të tyre.

Neni 10

Pala që ka interes të një natyre ligjore në lidhje me çështjen e mosmarrëveshjes që mund të cenohet nga vendimi i marrë për këtë çështje, mund të ndërhyjë gjatë procedimeve, me pëlqimin e gjykatës së arbitrazhit.

Neni 11

Gjykata e Arbitrazhit mund të dëgjojë dhe të vendosë kundërpaditë e ngritura drejtpërdrejt nga çështja në fjalë.

Neni 12

Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit si për procedurën dhe përmbajtjen, merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj.

Neni 13

1. Nëse njëra nga palët e mosmarrëveshjes nuk paraqitet para gjykatës së arbitrazhit ose nuk arrin të mbrojë çështjen e saj, pala tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të vazhdojë procedimet dhe të marrë vendimin. Mungesa e një pale ose pamundësia e saj për të mbrojtur çështjen nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedimeve.

2. Para marrjes së vendimit të formës së prerë, gjykata e arbitrazhit duhet të bindet që padia është e bazuar në fakte dhe në ligj.

Neni 14

Gjykata e Arbitrazhit merr vendim të formës së prerë brenda pesë muajve nga data kur kjo gjykatë është ngritur plotësisht, nëse nuk e çmon të nevojshme të zgjasë afatin kohor për një periudhë e cila nuk duhet të kalojë edhe pesë muaj të tjerë.

Neni 15

Vendimi i formës së prerë të gjykatës së arbitrazhit kufizohet në thelbin e mosmarrëveshjes dhe deklaron arsyet ku bazohet. Ai përmban emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në të, si edhe datën kur është marrë vendimi i formës së prerë. Çdo anëtar i gjykatës së arbitrazhit mund të bashkëlidhë një mendim të veçantë ose kundërshtues të vendimit të formës së prerë.

Neni 16

Vendimi është i detyrueshëm për palët e mosmarrëveshjes. Interpretimi i kësaj Konvente i dhënë nga vendimi është i detyrueshëm për palën që ndërhyr, sipas nenit 10 më sipër, në masën që ka lidhje me çështjet në lidhje me të cilat ka ndërhyrë ajo palë. Vendimi nuk apelohe nëse palët e mosmarrëveshjes nuk kanë rënë dakord më parë për procedurën e apelit.

Neni 17

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga marrja e vendimit të formës së prerë në përputhje me Nenin 16 më lart, në lidhje me interpretimin ose mënyrën e zbatimit të vendimit, mund të paraqitet nga ndonjë prej tyre për vendim në gjykatën e arbitrazhit që e ka marrë atë.

Pjesa II: Procedura e pajtimit

Për qëllime të paragrafit 6, neni 25 i kësaj Konvente, procedura e pajtimit është si më poshtë.

Neni 1

Kërkesa nga njëra palë e mosmarrëveshjes për të ngritur një komision pajtimi në përputhje me paragrafin 6 të Nenit 25 të kësaj Konvente, i dërgohet Sekretariatit me shkrim dhe një kopje palës ose palëve të tjera të mosmarrëveshjes. Sekretariati njofton menjëherë të gjitha Palët në përputhje me rrethanat.

Neni 2

1. Komisioni i pajtimit përbëhet nga tre anëtarë nëse palët nuk bien dakord ndryshe, një i emëruar nga secila palë e interesuar dhe një Kryetar i zgjedhur bashkërisht nga ata anëtarë.
2. Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet më shumë se dy palëve, palët me të njëjtat interesa i zgjedhin anëtarët e komisionit bashkërisht me marrëveshje.

Neni 3

Nëse palët e mosmarrëveshjes nuk kryejnë asnjë emërim brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës me shkrim nga Sekretariati i përmendur në nenin 1, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të një pale, bën caktimet e nevojshme brenda dy muajve të ardhshëm.

Neni 4

Nëse Kryetari i komisionit të pajtimit nuk është zgjedhur brenda dy muajve nga data e caktimit të anëtarit të dytë të komisionit, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara

cakton Kryetarin brenda dy muajve të ardhshëm, me kërkesë të secilës prej palëve të mosmarrëveshjes.

Neni 5

Komisioni i pajtimit i ndihmon palët e mosmarrëveshjes në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në përpjekjet e tyre për të arritur një zgjidhje miqësore.

Neni 6

1. Komisioni i pajtimit mund të kryejë procedurën pajtimit në mënyrë të përshtatshme, duke marrë plotësisht parasysh rrethanat e çështjes dhe pikëpamjet që palët e mosmarrëveshjes mund të shprehin, duke përfshirë çdo kërkesë për një rezolutë të shpejtë. Ajo mund të miratojë rregullat e veta të procedurës, nëse është e nevojshme, nëse palët nuk bien dakord ndryshe.

2. Komisioni i pajtimit, në çdo kohë gjatë procedurës, mund të bëjë propozime ose rekomandime për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 7

Palët e mosmarrëveshjes bashkëpunojnë me komisionin e pajtimit. Në veçanti, ato duhet të përpiqen të respektojnë kërkesat e Komisionit të paraqesin materiale me shkrim, të sigurojnë prova dhe të marrin pjesë në mbledhje. Palët dhe anëtarët e komisionit të pajtimit kanë detyrimin për të ruajtur fshehtësinë e çdo informacioni apo dokumenti që marrin në mirëbesim gjatë procedimeve të komisionit.

Neni 8

Komisioni i pajtimit i merr vendimet me shumicë votash nga anëtarët e tij.

Neni 9

Nëse mosmarrëveshja nuk është zgjidhur ende, Komisioni i pajtimit përpilon një raport me rekomandime për zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda dymbëdhjetë muajve nga koha kur është ngritur, të cilën palët e marrin në konsideratë në mirëbesim.

Neni 10

Çdo mosmarrëveshje për të cilën komisioni i pajtimit ka kompetencë ose jo për të marrë në shqyrtim një çështje që i referohet atij, vendoset nga komisioni.

Neni 11

Shpenzimet e Komisionit ndahen nga palët e mosmarrëveshjes në mënyrë të barabartë, nëse nuk bien dakord ndryshe. Komisioni regjistron të gjitha shpenzimet dhe përpilon një deklaratë përfundimtare për t'jua drejtuar palëve.